



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 23, datë 29.07.2026

PËR
RINOVIMIN PËR NJË PERIUDHË NJË VJEÇARE TË KONTRATAVE ME
BANKAT AGJENTE TË PËRZGJEDHURA NË LISTËN PARAPRAKE
PËR PERIUDHËN 2024-2026

Në bazë dhe në zbatim të nenit 42, pika 7 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 25, pika 2, pika 4 dhe pika 5 të Rregullores “Për kompensimin e depozitave të siguruar”, të miratuar me Urdhër të Guvernatorit nr. 3762, datë 18.07.2016, të ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit Drejtues nr. 18, datë 30.07.2024 “Mbi përzgjedhjen e bankave agjente në listën paraprake për periudhën 2024 - 2026”, të nenit 18 të rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave” të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014, si dhe me propozim të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Të rinovojë për një periudhë 1 (një) vjeçare kontratat me bankat agjente të përzgjedhura në listën paraprake për periudhën 2024 - 2026, duke filluar nga data 11.09.2026, si vijon:
 - Banka Kombëtare Tregtare SHA;
 - Banka Intesa Sanpaolo Albania SHA;
 - Banka OTP Albania SHA;
 - Banka Credins SHA.
2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm të njoftojë bankat e përzgjedhura në listën paraprake për periudhën 2024 - 2026, si dhe Autoritetin Mbikëqyrës lidhur me këtë vendim.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen





zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Donald Duraj

Shqipe Malaj

Kryetar

Sekretare

